



NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVË DISTRICT HEATING J.S.C. GJAKOVA

Adresa: "Behije Dashi", pn GJAKOVË, KOSOVË
Tel & Fax: +381 (0) 390 328 329

Nr. i Biznesit: 811326471

www.ngrohtorja.org

Datë: 13.04.2023

N.P." Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. Gjakovë në bazë të Ligjit të punës Nr. 03/L-212, Neni 8 dhe 21 i shpallur në GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 90 / 01 DHJETOR 2010, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ (MPMS) NR. 07/2017 për Rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, shpallë këtë:

KONKURS

Pozita e punës: Pastrues/e për marrëdhënie në punë
Kohëzgjatja e mandatit - 6 (gjashtë) muaj me mundësi vazhdimi.
Orari : Gjysmë orar (4 orë ne dite, 20 ore në javë)

Detyrat, përgjegjësitë dhe autoritetet:

- Bën pastrimin e objektit të zyrave të Ndërmarrjes;
- Pastron dyshemetë, muret, dritaret, banjot etj.;
- Pastron zyrat e administratës si dhe inventarin e zyrave;
- Pas kryerjes së pastrimit kujdeset dhe është përgjegjëse për kontrollimin dhe fikjen e dritave të panevojshme, bënë shkyçjen e aparateve për nxehje dhe ujit;
- Kujdeset për ajrosjen e lokaleve të punës;
- Mbyll dyert dhe dritaret e lokaleve zyrtare pas përfundimit të orarit zyrtar;
- Ndihton zyrtarët në shpërndarjen e materialeve të ndryshme nëpër ndërtesë;
- Kujdeset dhe mirëmban objektet dhe oborrit të Ndërmarrjes;
- Kujdeset për pastrimin e oborrit nga papastërtitë dhe materialet e panevojshme, të cilat pengojnë aktivitetin e punës në Ndërmarrje;
- Njofton me kohë Ndërmarrjen Përgjegjëse për pastrimin e kontejnerëve të mbushur me mbeturina dhe zëvendësimin e tyre;
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhrimit të Sekretarit dhe Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes si dhe udhëheqësve të departamenteve – zyrave përkatëse.

Kualifikimi dhe aftësitë:

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- CV.
- Aplikacioni të cilin mund ta merrni dhe ta plotësoni me rastin e dorëzimit të dokumentacionit.
- Të posedojë shkollën fillore .
- Përvojë e preferueshme ,
- Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj)

Kërkesat shitesë:

Të ketë aftësi fizike.

Të bashkëpunojë me punonjësit.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike, përkatësisht prej datës **13.04.2023** deri më **27.04.2023 në 16.00h.**

Testimi dhe intervistat mbahen në lokalet e ndërmarrjes pas përfundimit të afatit të konkursit.

Kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen me shkrim përmes E-mail adresës së shënuar në CV.

Dokumentacionet e kompletuara dorëzohen në N.P. "NGROHTORJA E QYTETIT" SH.A. - Gjakovë, rr. "Behije Dashi" p.n. – **Rezina.**

VËREJTJE: Aplikacionet e pa kompletuara sipas kriterëve të konkursit do të anulohen dhe nuk do të shqyrtohen.